



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIK OF KOSOVO

Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

Zyra e Prokurimit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

Nr. _____
09.10.2023
D r a g a s h

03Nr. Br. 400 - 15568/23
09.10.2023
Dragash - Dragaš

Në mbështetje të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/03 të datës 13.02.2003, dhe Udhzimit Administrativ MA;nr.05/07/06/2010 dhe 14/2011 për shitjen e trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore sipas Planit Vjetor të Menagjimit me Pyje Publike dhe llogaritjes së vlerës së trungjeve në këmbë nga vlersimi për tenderim / ankandin nr.621-2023-AP-004(Shitja e masës drusore –viti 2023- ankand) të mbajtur me 11.07.2023 në lokalet e Komunës në Dragash në mes të palëve të poshtë shenuara lidhet kjo :

KONTRATË

[PER SHITBLERJEN E ASORTIMENTEVE DRUNORE PER TENDER]

E lidhur në mes të ;

1. K.K -Dragash –zyra për prokurim të cilën e përfaqson Nuro Ismaili – Menaxher i zyrës së prokurimit [në tekstin e mëtejshëm punëdhësi] nga njëra anë dhe ;
2. BREDHIKU-SH.P.K me nr. Të biznesit 811417733 nga Suhareka të cilën e përfaqson Petrit Basha Drejtor [në tekstin e mëtejshëm punëmarrësi – blersi] nga ana tjetër

Neni 1.

Palët kontraktuese janë marr vesh që të bëjnë shitblerjen e masës drunore – teknike në Nj,Ek. -OPOJE. Ngastrat: nr.10,dhe 22/.

Masa drusore e ngastres 10= $54,50m^3 \times 24.25€ = 1,321.62 €$

22= $56.40m^3 \times 23.05 € = 1,300.02 €$

Gjithësej ; 2,621.64 € per pagese

Neni 2.

1. Punëmarrsi është i obliguar që pa përjashtim të nënshtrohet rregullave që do të caktoj Sherbimi Teknik, e të cilat janë në përputhshmeri me Ligjin Për Pyjet e Kosovës.
2. BREDHIKU- SH.P.K me nr.te Biznesit 811417733 nga Suhareka nuk ka të drejtë të kontraktoj me persona tjerë juridik dhe fizik për bartjen e të drejtave nga kjo kontratë pa pelqimin e punëdhësit.

Neni 3.

1. Përerja - Tërheqja e masës drunore duhet të filloj sa më parë që është e mundur, pas nënshkrimit të kontratës.

2. Nderkaq, punët e parapara me këtë kontratë duhet të përfundojnë me datë **20 .12.2023**. Ne baze të rekomandimit të Drejtorise se Bujqesise(sektorit të pylltarise ne Dragash)

Neni 4.

1. Punëmarrsi, ne emër të taksës per masen e blerë drusore sipas ngastrave të lartcekura ka për obligim të paguaj shumën për masën drusore sipas ofertes = **2,621.64** Euro
2. Pagesa bëhet në 2[dy] këste, kësti i par në vlerë prej **50%**, **garancion bankar ne pajtim me udhezimin Administrativ) (1310.82. euro)** e shumës përgjithshme bëhet pas nenshkrimit të kontratës [në të njejtën ditë] kesti i dytë në prej **50%(1310.82 euro)** bëhet pas kryerjes së **70%** të prerjes se masës drusore të punëve të parapara.

Punëmarrësi pas prezentimit të pagesës se kështit të pare në shërbimin teknik të Drejtoris komunale në Dragash fillon transportimin e masës drusore nga pylli.

Neni 5.

Pagesa duhet të bëhet në llogarin e Ministris Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Prishtinë, Nr.të xhirollogarisë **1000400070001150** po në të njejtën ditë nga data e marrjes së kontratës.

Neni 6.

Obligohet Shërbimi teknik i Drejtorisë Komunale ne Dragash qe Punëdhënësi ti sigurojë dokumentacionit përkatës deri në përfundimin e tërheqjes së masës drusore të parapar konform nenit 3 të kësaj kontrate.

Neni 7.

Në rastë kontesti sipas kësaj kontrate, kompetente për zgjidhjen e saj do të jet; **Gjykata Ekonomike në Prishtinë.**

Neni 8.

Kjo kontratë është e përpiluar në 4 egzenplar, prej të cilëve 2 janë punëdhënsin 1 për Shërbimin Teknik në Drejtorin Pyj.Kom. Dragash dhe 1 egzenplar për Punëmarrësin- blesin.

PALET KONTRAKTUESE

BREDHIKU-SH.P.K
Petrit Basha



Menaxheri i zyres prokurimit
Nuro Ismaili

